



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 834 Prot.

Tiranë, 11.02. 2020

VENDIM

Nr. 6, datë 11.02 2020

Për miratimin e rregullores 'Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Universitetin e Tiranës'

Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma d të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 31 të Statutit të Universitetit të Tiranës, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës pas shqyrtimit të draft-rregullores të paraqitur nga grupi i punës i ngritur me Vendimin e Senatit Akademik të UT-ës nr. 2, datë 29.01.2020 “Për miratimin e grupit të punës për hartimin e draft-rregullores ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Universitetin e Tiranës’”, në mbledhjen e tij të datës 11.02.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Universitetin e Tiranës”.
2. Kjo rregullore t’i përcillet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Interesave.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF.DR. MYNYR KONI



**UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

RREGULLORE

**“PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE
NË UNIVERSITETIN E TIRANËS”**

**Miratuar me Vendimin nr. 6, datë 11.02.2020 të Senatit Akademik
të Universitetit të Tiranës**

Tiranë, 2020



RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit në Universitetin e Tiranës, bazohet në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.

Neni 2 Përkufizime

1. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në UT.
2. "Eprorët e zyrtarëve" sipas hierarkisë, brenda institucionit të UT-së janë: Rektori, Administratori, zv.Rektori, Dekani, Administratori i Fakultetit, zv.Dekani, Përgjegjësi i Departamentit.
3. "Person i lidhur me një zyrtar të UT-së" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, me zyrtarin sipas nenit 5, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.
4. "Parim i proporcionalitetit" është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari ose institucioni publik me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë ose kompetencat e zyrtarit, aq më të shumta janë kufizimet e interesave të zyrtarit, aq më të ashpra janë dënimet dhe në mënyrë edhe më të hollësishme janë përcaktuar rregullat, mënyrat, mjetet dhe procedurat për parandalimin e konfliktit të interesit nga institucionet publike.

Neni 3 Fusha e zbatimit

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

1. Çdo zyrtar i UT-së, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 të ndryshuar, në ligjin për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e UT-së;
2. Çdo zyrtar i UT-së, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për akte dhe kontrata administrative;
3. Çdo zyrtar i UT-së kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për kontrata që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile;
4. Personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar dhe në Kodin Procedurave Administrative.



Neni 4 Çastet paraprake të vendimmarrjes

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

1. Vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
2. Vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas pikës 1 të këtij neni, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:
 - i) hartimin e projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin e tij organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;
 - ii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër, të dokumentuar për këtë projektakt nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;
 - iii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;
 - iv) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
 - v) përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetëj përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projektkontratës në tërësinë e tyre;
 - vi) çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit dhe të veprimtarisë së UT-së.

Neni 5 Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar i UT-së ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 4 të rregullores, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:
 - a) roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negociimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
 - b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive për subjektet dhe/ose ish-subjektet e UT-së në kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit dhe të ndjekjes, informacione për politikën ekonomike qeveritare dhe administrimin financiar;



- c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të UT-së:
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga Këshilli i Etikës i UT-së.
 4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.
 5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private ne zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
 6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të zyrtarit, veprohet sipas nenit 37 të ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar .

Neni 6 Interesat private

1. Interesat private të një zyrtari janë ato interesa që parashikon neni 5 i ligjit 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, e konkretisht:
 - a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
 - b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
 - c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
 - d) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
 - e) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijojnë të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
 - f) marrëdhënie:
 - i) familjare apo të bashkëjetesës;
 - ii) të komunitetit;
 - iii) etnike;
 - iv) fetare;
 - v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
 - e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendura në gërmat e mësipërme të këtij neni.
2. Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.
3. Nëse në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005 , i ndryshuar, dhe anasjelltas
4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe lidhje apo



gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 dhe 4 të nenit 3 të ligjit të lartpërmendur.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE RAST PAS RASTI TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave

Neni 7

Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit

1. Çdo zyrtar i UT-së, sipas përcaktimit të këtij termi në pikat 1 dhe 2 të nenit 2 të kësaj rregulloreje, që mbikëqyrin ose përdorin fonde publike, që lidhin kontrata shërbimi, furnizimi apo investimi, që përfaqësojnë UT-në në marrëdhënie me të tretët, në ushtrimin e kompetencave ose në kryerjen e detyrave të tyre funksionale ose të ngarkuara përkohësisht, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat, që mund të bëhet shkak për lindjen e konfliktit të interesit ose çdo vendimarrje tjetër që mund të bëhen shkak për lindjen e konfliktit të interesave.
2. Deklarimi, si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimarrje për një akt dhe/ose për subjekte të deklarimit periodik të interesave private në UT.
4. Rektori, Administratori i UT-së, me mbështetjen e Këshillit të Etikës, si Autoritetit Përgjegjës i UT-së, dhe në bazë të vetëdeklarimit të zyrtarit të UT-së si dhe në bazë të të dhënave që ka, merr masat e nevojshme që të shmangë emërimin, në bazë të konkurseve publike, e një zyrtari në pozicione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash. Rektori, Administratori i UT-së merr masa që zyrtarit të mos t'i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti të mundshëm interesash.

Neni 8

Identifikimi i interesave private të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit, për interesat private të zyrtarit në UT-së, është:
 - a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijeni;
 - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi dhe që përputhet me qëllimin e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat private të një zyrtari dhe punonjësi të UT-së mund të jenë edhe:
 - a) regjistrat publikë ose private, të mbajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) të dhënat nga media;



- c) të dhënat ose ankesat nga publiku;
- ç) çdo burim tjetër i ligjshëm.

Neni 9

Lëshimi i autorizimit nga zyrtari i UT-së

1. UT-ja vë në dispozicion të zyrtarëve të saj modelin e autorizimit në formën dhe përmbajtjen e miratuar nga ILDKPKI, të cilët duhet ta nënshkruajnë brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në UT.
2. UT-ja e cila vihet në dijeni me të dhëna personale të çdo zyrtari detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit, nëse diçka e tillë nuk është parashikuar ndryshe në ligj.
3. Në rastin e Rektorit dhe Administratorit, autorizimi vihet në dispozicion në ILDKPKI.

Neni 10

Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ILDKPKI.
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji sipas hierarkisë në UT-ja janë:
 - a) Rektori
 - b) Administratori
 - c) Këshilli i Etikës si Autoritet Përgjegjës i UT-së.

Neni 11

Detyrat e Autoritetit Përgjegjës të UT-së

Këshilli i Etikës është Autoritet Përgjegjës i UT-së për konfliktin e interesit dhe kryen detyrat e mëposhtme:

- a) mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve të UT-së;
- b) shpërndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t'u lëshuar nga zyrtarët e UT-së, sipas nenit 10 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, te ndryshuar, dhe nenit 9 të kësaj rregulloreje;
- c) krijon regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
- ç) bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve të UT-së, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
 - i. konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);
 - ii. konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- d) kryen verifikim të interesave të deklaruara apo të padeklaruara të zyrtarëve dhe punonjësve të këtij institucioni, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë, sipas rastit Rektorin ose Administratorin.



- dh) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar;
- d) përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;
- ë) merr masa për të siguruar aksesin e informimit e publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit;
- f) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike
 - i. marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështesin UT-në në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshpërblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshpërblimit të zyrtarët përgjegjës;
 - ii. orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të UT-së, në përputhje me rregulloren dhe urdhrat e miratuara nga Rektori;
 - iii. shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga Rektori i UT-së, për zbatimin e këtij ligji, si dhe për përmirësime në ligje të tjera kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;
- gj) informon zyrtarët dhe punonjësit e UT-së për çdo ndryshim të akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.
- h) mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të UT-së për zyrtarët e këtij institucioni;
- i) ndjek e zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj Rregulloreje ose urdhrave të Rektorit.

Neni 12

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të UT-së, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga Këshilli i Etikës si Autoriteti Përgjegjës i UT-së.

Neni 13

Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit

Këshilli i Etikës, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit të UT-së, interesat private të tij shkak për konflikt interesi, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët si dhe nga ILDKPKI.



Seksioni II
Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave private

Neni 14

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklaram periodik të interesave private

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të UT-së bëhet sipas kërkesave të Kreut II të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e UT-së, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklaram të interesave private periodike janë:
 - a) Rektori i UT-së;
 - b) Administratori i UT-së
3. Gjithashtu, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar mbartin detyrim për deklaram të interesave private periodike bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të UT, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.
4. Çdo zyrtar i UT-së, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklaramit të interesave private periodike në ILDKPKI, ose kur kalon në një pozicion që nuk mbart detyrimin për deklaram, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar "Deklaratë pas largimit nga funksioni". Drejtoria e Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk mund të bëjnë dorëzimin e librezës së punës, të librezës së kontributeve shoqërore, të çdo dokumenti tjetër që mund t'i takojnë zyrtarit, në rast se ky i fundit nuk plotëson këtë detyrim ligjor.

Neni 15

Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e UT-së, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:
 - a) zyrtari i UT-së, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndërshkuese mbi shtetasin informues (qofte ky dhe subjekt i UT-së), dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
 - b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i UT-së, që qëndron në marrëdhënie varësie hierarkike mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.
2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të UT-së është ai në dukje, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) kur zyrtari i UT-së është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
 - b) kur vetëpërjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është i pamundur delegimi i kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
 - c) kur vendimet e zyrtarit të UT-së, sipas rregullimeve me ligj nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;
 - d) kur nuk është i mundur transferimi apo tjetërsimi i interesit privat për shkak



- të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);
- e) kur nuk ka kuptim që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i UT-së të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga Rektori i UT-së si dhe nga ILDKPKI. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

Neni 16

Kufizimi i interesave private për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

1. Rektori dhe Administratori i UT-së:

- a) nuk mund të jetë drejtues në organizatat fitimprurëse;
- b) nuk mund të jetë anëtar në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, kur këto ushtrojnë veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, me akte të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri a organizata apo mbi shoqëri ose organizata të tjera që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, përjashtuar rastet kur ky pozicion në shoqëri ose organizatë vjen për shkak të funksionit dhe/ose të statusit;
- c) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a të përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni, dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;
- d) mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, rast në të cilin zyrtari mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 27 të ligjit 9367, datë 07.04.2005 të ndryshuar.

Neni 17

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar në UT të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në UT, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës apo është ose duket sikur është shpërblim për



mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

- a) "Dhurata", sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 i ndryshuar dhe në VKM nr. 714, datë 22.10.2004 "Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike" i ndryshuar ;
 - b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.
2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
 3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.
 4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 i ndryshuar dhe në VKM nr.714, datë 22.10.2004 i ndryshuar;
 5. Në asnjë rast zyrtari i UT-së nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
 6. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

Neni 18

Prania dhe kufizimi i interesave private të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e UT-së, për kufizimet e interesave private të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 16 e 17 të kësaj rregulloreje janë përkatësisht:
 - a) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesit/es, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es;
 - b) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.
2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e UT-së, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
3. Përsa i përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e UT-së dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtpërdrejt parashikimet e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.
4. Personi i lidhur me zyrtarin e UT-së, nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritët me sferën e juridiksionit të zyrtarit të UT-së dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet kushti i mëposhtëm:



- a) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin e parashikuar nga ligji.

Neni 19

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët/punonjësit e UT-së bëhen sipas kreut IV të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 , i ndryshuar .

Neni 20

Deklaratat për konfliktin e interesave dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 21

Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, nga zyrtarët përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me Kodin e Punës, ligjin për arsimin e lartë, Statutin dhe Rregulloren e UT-së. Për masat disiplinore të marra nga institucionet përkatëse, njoftohet rast pas rasti ILDKPKI.

Neni 22

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

Asnjë nga dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të UT-së, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtëpërdrejt dispozitat e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

Neni 23

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. MYNYR KONE

